



Nisma: Mbështetje për kërkimin operacional në shëndetësi

Projekti "Shëndet për të Gjithë" është projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, SDC, që po zbatohet nga Instituti Zviceran i Shëndetit Publik dhe Mjekësisë Tropikale dhe Qendra HAP



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

Swiss TPH 
Swiss Tropical and Public Health Institute

Trualli

"Shëndet për të Gjithë", një projekt i SDC-së në Shqipëri, promovoi një nismë financimi për të mbështetur krijimin e kapaciteteve kërkimore nëpërmjet aplikimit për mikro-grante në kërkimin operacional në shëndetësi.

Nga 17 janari deri më 20 shkurt 2020, HAP ftoi kërkues të rinj (nën moshën 35 vjeç) që të aplikojnë për ndihmë financiare për kërkime operationale në fusha të caktuara të shëndetësisë siç janë burimet njerëzore në shëndetësi, sëmundjet jo të transmetueshme si çështje të shëndetit publik, sistemi i informacionit shëndetësor në kujdesin shëndetësor parësor dhe më gjerë, cilësia e kujdesit shëndetësor parësor në Shqipëri etj.

Si rezultat i kësaj, paraqitën propozimet e tyre për kërkim 45 aplikantë brenda datës 20 shkurt 2020. Aplikantët kanë formime të ndryshme:

- 31% e aplikantëve kanë formim mjekësor
- 25% formim në shëndetin publik
- 22% formim në shkencat teknike mjekësore
- 13% në ekonomi
- 9% në shkencat sociale

Përvoja mesatare e punës është 6.4 vjet dhe përfaqësimi gjinor është 89% aplikante femra dhe 11% meshkuj.

Një komision i pavarur, i përbërë nga akademikë dhe studiues shkencorë, përfaqësues të tre Universiteteve dhe Institucioneve Kërkimore në Shqipëri vlerësoi 45 aplikimet. Vlerësimi është bërë sipas kriterëve të publikuara në thirrjen për aplikim:

- Propozimi i kërkimit të studimit (protokolli i studimit)- deri në 40 pikë
- Plani i punës dhe afati kohor me aktivitete specifike - deri në 30 pikë
- CV të aplikantit për kërkim dhe një letër motivimi - deri në 10 pikë
- CV të mentorit (mentorëve) - deri në 20 pikë

Sivjet u përzgjedhën 11 aplikime bazuar në pikët totale dhënë nga vlerësuesit e pavarur dhe buxhetit të projektit për këtë aktivitet. Lista e propozimeve fituese paraqitet më poshtë.

HAP dëshiron të falënderojë të gjithë aplikantët për paraqitjen e propozimeve të tyre dhe inkurajon kërkuesit e rinj që të aplikojnë në thirrjen e ardhshme.

01

Titulli:

Përshtatja dhe vlefshmëria ndër-kulturore e instrumentit të politikave të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (MBNj) dhe shkalla e indeksit të mjedisit praktik tëpunës së infermierit (SHMP - IPI) në sistemin e Kujdesit Shëndetësor Parësor në Shqipëri (KSHP).

Qëllimi:

Qëllimi i projektit kërkimor është të vërtetojë dy mjete të dobishme për vlerësimin e mjedisit infermieror të punës në kujdesin shëndetësor parësor, si faktorin kryesor të Burimeve Njerëzore për ofrimin e shërbimeve cilësore në KSHP.

Autori: E. Luzi

02

Titulli:

Programi i kontrollit bazë shëndetësor të popullatës 35-70 vjeç si një mjet shumë i rëndësishëm për parandalimin dhe zbulimin e hershëm të shumë sëmundjeve në kujdesin shëndetësor parësor.

Qëllimi:

Qëllimi i projektit kërkimor është të japë një analizë të thelluar shkencore të të dhënave të kontrollit bazë shëndetësor dhe shpërndarjen e rezultateve që lidhen me programin bazë të kontrollit mjekësor në qarkun e Tiranës.

Autori: Q. Dika

03

Titulli:

Vlerësimi i cilësisë të shërbimeve parandaluese dhe këshilluese të shëndetit të nënës dhe fëmijës sipas perceptimit të përdoruesve të shërbimeve në Durrës dhe Fier.

Qëllimi:

Qëllimi i projektit kërkimor është të vlerësojë cilësinë e perceptuar të shërbimeve të konsultorit të nënës dhe fëmijës lidhur me kujdesin gjatë shtatzënisë; vizitave në shtëpi; kujdesin për fëmijën, si dhe rreket të kuptojë dhe shpjegojë pengesat për marrjen e shërbimit të duhur gjatë shtatzënisë ose gjatë mirërritjes së fëmijës.

Autori: E. Demollari

04

Titulli:

Ngurimi për t'u vaksinuar - qëndrimet, ndërgjegjësimi dhe praktika e vaksinimit të fëmijëve të prindërve dhe kujdestarëve në Shqipëri.

Qëllimi:

Qëllimi i projektit kërkimor është të sigurojë një nivel të lartë të vaksinimit sipas kalendarit të imunizimit të detyrueshëm duke promovuar efikasitetin e vaksinave dhe duke inkurajuar ndërhyrjet e parandalimit parësor.

Autori: E. Gjini

05

Titulli:

Treguesit e përdorimit dhe keqpërdorimit të benzodiazepinave në Shqipëri.

Qëllimi:

Qëllimi i projektit kërkimor është përdorimi i Benzodiazepinave (BDZs), hetimi i treguesve të keqpërdorimit të tyre me anë të përdorimit të metodologjisë ATC/ DDD të OBSH-së dhe evidentimi i grupeve të synuara të popullatës më të rrezikuara për të krijuar varësi dhe abuzim nga BDZ-të.

Autori: J. Mihani

06

Titulli:

Roli i kujdesit shëndetësor parësor në identifikimin e faktorëve të riskut të sëmundjeve jo të transmetueshme në Shqipëri

Qëllimi:

Qëllimi i projektit kërkimor është të identifikojë rolin e kujdesit shëndetësor parësor në depistimin dhe identifikimin sasior të prevalencës së faktorëve të riskut të sëmundjeve jo të transmetueshme në popullsinë shqiptare.

Autori: A. Shpuza

07

Titulli:

Vlerësimi i faktorëve përcaktues të kënaqësisë së personelit të kujdesit shëndetësor dhe të përdoruesve të kujdesit shëndetësor parësor në Tiranë, Shqipëri.

Qëllimi:

Qëllimi i projektit kërkimor është vlerësimi i nivelit të kënaqësisë së përdoruesve të kujdesit shëndetësor parësor dhe ofruesve të kujdesit shëndetësor, si dhe përcaktimi i faktorëve socialë dhe demografikë të lidhur me kënaqësinë e përdoruesve dhe të ofruesve në kujdesin shëndetësor parësor në Bashkinë e Tiranës.

Autori: A. Naum

08

Titulli:

Kënaqësia në punë dhe niveli i motivimit të infermierëve që punojnë në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor

Qëllimi:

Qëllimi i projektit kërkimor është të përcaktojë kënaqësinë në punë të infermierëve që punojnë në Qendrat e Kujdesit Parësor. Studimi do të zhvillohet në KSHP, Tiranë.

Autori: A. Luzi

09

Titulli:

Niveli i vetë-kujdesit te personat me diabet të tipit 2 në qytetin e Vlorës, Shqipëri - implikime për kujdesin shëndetësor parësor.

Qëllimi:

Qëllimi i projektit kërkimor është të vlerësojë nivelin e vetë-kujdesit dhe vetë-menaxhimit te pacientët me diabet të tipit 2, të cilët trajtohen në shërbimet shëndetësore parësore.

Autori: J. Jaho

10

Titulli:

Njohuritë dhe qëndrimet e mjekut të përgjithshëm lidhur me psikozën e hershme/ skizofreninë - një studim në kujdesin shëndetësor parësor Tiranë, Shqipëri.

Qëllimi:

Qëllimi i projektit kërkimor është të vlerësojë informacionin e mbledhur lidhur me njohuritë dhe qëndrimet e mjekëve të përgjithshëm të Tiranës (MP) lidhur me psikozën e hershme dhe skizofreninë.

Autori: E. Dashi

11

Titulli:

Kënaqësia e pacientëve me cilësinë e shërbimit shëndetësor parësor - rasti i Qendrës Shëndetësore të Bashkisë së Shijakut.

Qëllimi:

Qëllimi i projektit kërkimor është të vlerësojë kënaqësinë e pacientëve me cilësinë e shërbimeve shëndetësore të ofruara nga Kujdesi Shëndetësor Parësor i Bashkisë së Shijakut.

Autori: S. Kurti